





ENVIRONMENTAL  
FILM FESTIVAL  
2013 ALBANIA



Hyrja e Lirë

**FESTIVALI I FILMIT**

**MJEDISOR**

Tiranë - Shkodër - Vlorë  
Korçë - Pogradec - Elbasan

**22 - 25 maj 2013**

follow us 

Grupi i I  
KOPSHITI 5 (10)







## **Të dashur pjesëmarrës, të ftuar, zonja dhe zotërinj,**

Ndihem i nderuar të hap edicionin e parë të Festivalit të Filmit Mjedisor në Shqipëri.

Është kënaqësi e madhe të jesh pjesë e kësaj sfide emocionuese dhe deshiroj të falenderoj çdo mbështetës që ka ndihmuar në realizimin e tij. Shpreh mirënjohjen time të thellë për profesionistët e mjedisit, profesionistët e kinemasë, shkencëtarët, mjedisorët, komunitetin e OJF-ve, Kryetarët e nderuar të bashkive të Tiranës, Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Pogradecit dhe Vlorës, ekipin e përkushtuar të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe së fundi, por jo më pak i rëndësishëm, Delegacionin Evropian në Shqipëri dhe çdo shtet kontribues anëtar të BE-se si dhe çdo Agjensi dhe Organizatë Ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit është qëllimi ynë final në mbrojtjen e jetës në planetin tokë. Kjo ka të bëjë me mbrojtjen e së ardhmes tonë, të llojit tonë dhe të brezave të ardhshëm. Në mënyrë që të arrijmë qëllimin tonë ne kemi nevojë për aleatë, ne kemi nevojë për mbështetjen e publikut, ne kemi nevojë për mbështetjen e gjithë shoqërisë.

Shqipëria është vendi i detit blu, dunave ranore, brigjeve shkëmbore, lagunave bregdetare, i liqeneve të lashtë, i kodrinave të gjelbëruara dhe maleve të thepisur. Shqipëria është vendi i njerëzve që jetojnë ngushtësisht me mjedisin rrethues.

Por Shqipëria është njëkohësisht vendi ku mjedisi dëmtohet e ndotet, vendi ku shkatërrimi i mjedisit sjell varfërim të pejsazhit por dhe të vetë jetës. Është detyra dhe trashëgimia jonë që të ruajmë dhe të promovojmë vlerat mjedisore për një jetë më të mirë, sot dhe nesër.

Festivali i parë i filmit mjedisor është një nga këto rrugë të së ardhmes së mirë. Festivali tregon anët e këndshme dhe të pakëndshme të mjedisit lokal dhe global. Festivali është kontributi ynë afatgjatë për një shoqëri të ndërgjegjshme që do të sjellë ndryshimin e sjelljes sonë me mjedisin. Festivali është kontributi ynë për një sjellje më të mirë, për një politikë më të denjë, për një mjedis më të shëndetshëm, për një jetë më cilësore, për një Shqipëri më krenare.

Unë kam besim se ky festival filmi do të na ndihmojë ta bëjmë publikun aleatin tonë më të fortë.

Ky festival do të përkthehet në veprime për mbrojtjen e llojeve, habitateve, ekosistemeve, biodiversitetit, natyrës sonë dhe mjedisit tonë.

Ju faleminderit dhe shijoni me ne këtë eksperiencë të shkëlqyer nga Shqipëria dhe e gjithë bota.

**Fatmir MEDIU**

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave i Republikës së Shqipërisë

## **Dear Participants, Guests, Ladies and Gentlemen,**

I feel honoured to address and launch the very first edition of the Environmental Film Festival in Albania.

It is a great pleasure to be part of this exciting enterprise and I would like to thank any contributor who helped to make it happen. My deep gratitude goes to environmental professionals, cinema professionals, researchers, environmentalists, NGO community, our honourable mayors of Tirana, Korca, Elbasan, Shkodra, Pogradec and Vlora, the devoted staff of Ministry of Environment, Forestry and Water Administration and at last but not the least to the EU Delegation in Albania and every contributing EU country, International Agency and Organisation.

Protecting our environment is our ultimate goal in protecting life in planet earth. It is about protection of our future, our keen and future generations. In order to reach our goal we need allies, we need the support of the public, we need the support of the entire society.

Albania is the country of blue sea, sand dunes, rocky coasts, coastal lagoons, ancient lakes, green valleys and abrupt mountains. Albania is the country of people that live in close connection with surrounding environment.

But, at the same time, Albania is the place where environment is damaged and polluted, the country where the exploitation of environment might bring the impoverishment of landscape and the quality of life.

It is our duty to preserve and promote the environmental values for a better life, for today and tomorrow.

The first edition of Environmental Film Festival is one of the different paths towards a better future. The festival will demonstrate pleasing and unpleasing characteristics of local and global environment. The festival would show to the people the actual situation, and the risks linked with this situation.

The festival is our long-term contribution for a responsible society that would bring a change in our behaviour towards our environment. The festival is our contribution for a better environmental behaviour, for a more descent environmental policy, for a healthier environment, for a better quality of life and for a more proud Albania.

I am confident that this film festival will help us in making the public our strongest ally. This festival will be translated in actions for protecting species, our habitats, our ecosystems, our biodiversity, our nature and our environment.

Thank you and enjoy with us this magnificent experience from Albania and all over the world.

**Fatmir MEDIU**  
*Ministry of Environment,  
Forests and Water Administration*



## **Të dashur adhures të kinemasë,**

Kam kënaqësinë të njoftoj hapjen e edicionit të parë të Festivalit të Filmit Mjedisor në Shqipëri.

Të mbrosh diçka duhet ta duash atë. Dhe të duash diçka, duhet ta njohësh më parë.

Kinemaja është shumë e rëndësishme në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut. Ndhmon në transmetimin e mesazhit tek audienca dhe i mundëson qytetarit të jetë i hapur për botën.

Kinemaja është një mjet i fuqishëm dhe efektiv: për të na treguar histori... ndonjëherë magjepsëse, imponuese, histori të paimagjinuara, ndonjëherë të dhimbshme apo të lumtura, histori prekëse ose humoristike, por gjithmonë për të arritur të njëjtin qëllim: të mos na lërë indiferent ose të pashqetësuar. Filmi është burim mendimi.

Edicioni i parë i Festivalit të Filmit Mjedisor në Shqipëri do ju serviri për katër ditë me rradhë nga 22 – 25 maj filma mjedisor unik dhe madhështor në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Pogradec dhe Korçë.

Uroj që festivali do te tregojë rolin e mjedisit në zhvillimin njerëzor, do të rrisë ndërgjegjësimin mbi mjedisin, dhe përmirësojë mbrojtjen e natyrës në të njëjtën linjë me vlerat mjedisore të shpërndara kudo në botë.

Festivali është një nismë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në Shqipëri e mbështetur nga Delegacioni Evropian me GIZ. Këtë nismë e kanë mbështetur gjithashtu shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Organizata Ndërkombëtare, artistë dhe OJF. Disa kanë sjellë filma, disa kanë kontribuar në mënyrë teknike ose financiare.

Dua të falenderoj të gjithë partnerët të cilët pranuan të ndihmonin grupin organizator të Festivalit.

Do të shfaqen shumë dokumentarë Shqiptarë të prodhuara nga Akademia e Filmit Marubi dhe të financuar nga BE, fonde IPA, si dhe dokumentarë të OJF-ve të ndryshme.

Festivali gjithashtu do të shfaqë filma prestigjioz nga Italia, Franca, SHBA, Kanadaja si dhe nga Agjensia Evropiane e Mjedisit. Disa nga këta filma janë përzgjedhur në Festivalin e Kanës ose kanë marrë çmime të ndryshme nëpër festivale kudo në botë.

Të gjithë ne do të kemi mundësinë të ndjekim histori imponuese mbi natyrën dhe mjedisin si nga Shqipëria dhe nga bota. Kjo është mjaft e rëndësishme sepse mbrojtja e mjedisit nuk është problem vetjak i çdo shteti. Pylli, zogu, insekti nuk është vetëm një pyll, një zog, një insekt por ato janë pjesë e sistemit. Ndaj ne duhet t'i mbrojmë ato. E ardhmja e tyre është e ardhmja jonë.

Çfarë ne jemi sot është rezultat i veprimeve tona të shkuara. Çfarëdo që ne dëshirojmë të jemi në të ardhmen varet nga veprimet e sotme. Një shoqëri përkufizohet jo vetëm me çfarë krijon, por nga çfarë refuzon të prishë. Ne duhet të vendosim si të veprojmë sot.

Më lejoni t'ju uroj që Festivali thjeshtësisht dhe modestisht të ndihmojë të na mbajë të lidhur me botën natyrë dhe të ndërmarrim masa për të shpëtuar dhe mbrojtur mjedisin dhe më së fundmi mbijetesën në planet.

Faleminderit dhe gëzojeni Festivalin e parë të Filmit Mjedisor në Shqipëri!

**Ambasadori Ettore SEQUI**

*Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri*

**Dear cinema lovers,**

I am pleased to announce the first edition of the Environmental Film Festival in Albania.

To protect something you have to love it. And to love something, you have before to know it.

Cinema is an important key in education and public awareness. It helps to pass messages through large audiences and enables citizen to be open to the world. Cinema is a very powerful and effective tool: to tell us stories... Sometimes fascinating, compelling, unpredictable stories, sometimes sad or happy, moving or funny stories, but always trying to reach the same goal: never let us indifferent or unconcerned. A film is a fountain of thought.

The first edition of the Environmental Film Festival in Albania will offer you superb and unique environmental films and documentaries in the cities of Tirana, Shkodra, Vlora, Elbasan, Pogradec and Korca during four days from 22nd to 25th May.

I wish that the Festival will show the role of the environment in human development, increase environmental awareness, and improve nature protection in line with the environmental values shared worldwide.

The Festival is an initiative of the Ministry of Environment of Albania supported by the European Union and GIZ. It has also been embraced by the EU Member States, International Organizations, NGO's artists and designers. Some have brought movies; some have contributed technically or financially.

I would like to thank all the partners whom agreed to help the Festival organization team.

Many documentaries, filmed in Albania, financed by EU IPA funds and produced by the Academy of Film Marubi will be shown, as well as documentaries from various NGO's.

The Festival also proposes prestigious films from Italy, France, USA, Canada, as well from the European Environmental Agency. Some of these films have been in official selection at Cannes Festival or have received awards in numerous festivals around the globe.

All of us will be able to enjoy very compelling stories about nature and environment coming from Albania and from all over the world. This is important, because the protection of environment it is not a private problem of each country. A forest, a bird, a bug, is not only a forest, a bird, a bug, but they are part of a system. That is why we have to protect them. Their future is our future.

What we are today is result of our own past actions. Whatever we wish to be in future depends on our present actions. A society is defined not only by what it creates, but by what it refuses to destroy. We need to decide how to act now.

Let me wish that the present Festival can simply help us to keep connected with our natural world and to take action to save and protect the environment, and ultimately our survival on the Planet.

Thank you and enjoy the First Environmental Film Festival in Albania!

***Ambassador Ettore SEQUI***  
*Head of the Delegation of the European Union to Albania*



## TRASHED / HEDHURINË (2012)

*Pjesëmarrës në Festivalin e Kanës 2012  
SHBA - Në drejtimin e Candida Brady.  
Me pjesëmarrjen e Jeremy Irons -  
Kohëzgjatja: 98 min*

“Trashed” është një hetim provokues i një prej industrive me rritjen më të shpejtë në Amerikën e Veriut, sipërmarrjen e mbetjeve. Filmi shqyrton një element thelbësor të kulturës bashkëkohore amerikane...depozitimin e asaj që shoqëria jonë e quan “mbeturinë”. Kjo çështje preket nga çdo amerikan, shumica e të cilëve kurrë s’i vlerësojnë pasojat. Dhe, mesa duket, as edhe mënyrën si preket biosfera. Shpeshherë me humor, por thellësisht fshikullues, “Trashed” shtjellon për sasinë e mbetjeve në Amerikë që po arrin shpejt gjysmë miliardë tonë çdo vit.

Ç’efekte do të kenë tërë këto mbetje tek burimet natyrore që janë në rrezik? Përse prodhohen kaq shumë mbetje? Kush preket më shumë kur çdo amerikan prodhon të paktën 2,5 kg në ditë? Dhe kush do që Amerika të prodhojë më shumë?

Filmi analizon shkaqet dhe efektet e një veprimi në dukje të padëmshëm të “nxjerrjes jashtë të plehrave”, e ndërkaq demonstroi individët, veprimtarët dhe grupet e advokacisë që orvaten të ndryshojnë e reformojnë modelin e sotëm. “Trashed” është një film informues dhe mendjendritës që lypset ta shohë çdokush që interesohet në të ardhmen e qëndrueshme.

<http://www.trashedfilm.com/index.php>

## TRASHED (2012)

*Official Selection in the Festival de Cannes 2012*

*USA - Directed by Candida Brady. With the participation of Jeremy Irons -*

*Running time: 98 min*

“Trashed” is an investigation in North America about garbage business. The film examines a fundamental element of modern American culture...the disposal of what our society defines as “waste.” It is an issue influenced by every American, most of whom never consider the consequences. Nor, it seems, the implications to our biosphere. At times humorous, but deeply poignant, “Trashed” examines the American waste stream fast approaching a half billion tons annually.

<http://www.trashedfilm.com/index.php>

**BURIMET E MBETJEVE  
WASTE RESOURCES**

*2.570 million ton mbetje janë gjeneruar në BE për vitin 2010....*

*2 570 million tonnes of waste have been produced in EU in 2010...*





## UNFINISHED ITALY / ITALIA E PAPËRFUNDUAR (2011)

*ITALI - Në drejtimin e Benoit Felici -  
Kohëzgjatja: 34 min*

"Ngrahinat e pambaruara kanë një bukuri që mund të ishte. Që nuk është ende aty. Që mund të jetë aty një ditë."

(Frymëzuar nga "Le temps en ruines" nga Marc Augé). Italia, shtëpi e rrënojave: Një depërtim në stilin arkitekturor të pambaruar të Italisë së pasluftës së dytë botërore deri sot.

Ngrahina në një periudhë kalimtare mes përsosmërisë dhe asgjësë, të lëna në mes të ndërtimit, të rrënuara para se të përdroreshin, janë pjesë integrale e peisazhit arkitekturor italian: stadium pa audiencë, spitale pa pacientë, teatro që pas 50 vitesh ende s'kanë parë një premierë.

Është një studim i vlerave potenciale të ngrahinave të pambaruara në Itali, dhe i aftësisë njerëzore për t'ua përshtatur ato nevojave të përditshme. Këto rrënoja, e ardhmja e të

cilave tashmë ka kaluar, dhe e tashmja e të cilave mban shijen e pritjes së përjetshme, veprojnë si një ftesë për të medituar për kohën.

2012 – Fitues i Festivalit Ndërkombëtar të Mjedisit - Dokumentari më i mirë i shkurtër

2011 - Fitues i Festivalit Ndërkombëtar të filmit Sediciorto – Filmi më i mirë i Cortitalia dhe CNC (Centro Nazionale Cortometraggio)

Dhe shumë të tjera...

<http://www.unfinished-italy.com/>

## UNFINISHED ITALY (2011)

*ITALY - Directed by Benoit Felici - Running Time: 34 min*

"Unfinished buildings have the beauty of this which could have been. Of this which is not yet there. Of this which might be one day." (Inspired by "Le temps en ruines" by Marc Augé)

Italy, home of ruins: A foray into the unfinished, Italy's most prominent architectural style between the end of WW2 and the present day. Buildings in a limbo between perfection and nothingness, given up on halfway through their construction, fallen into ruin before they were ever used, are an integral part of the Italian architectural landscape: Stadiums without audiences, hospitals without patients, theatres that after 50 years have not yet seen their premiere. This is a study of the potential value of unfinished buildings in Italy and of man's ability to adapt them to his everyday needs. These ruins, whose future has already passed and whose present carries the taste of an eternal wait, act as an invitation to meditate about time.

-2012 - WINNER Le Festival international du Film d'Environnement - Best short documentary

-2011 - WINNER Sediciorto International Film Festival - Best Film Cortitalia and Special Mention CNC (Centro Nazionale Cortometraggio)

-And many others...

<http://www.unfinished-italy.com/>



**PELIKANI  
KAÇURREL (2013)  
SHQIPËRI - Në drejtimin e  
Eol Çashku -**

**Kohëzgjatja: 20 min**

Një ekspert i apasionuar i biodiversitetit, dhe Zv. Ministër për Mjedisin, është duke vëzhguar zogjtë nga një distancë e largët. Shumë lloje të ndryshme zogjsh popullojnë Lagu-

nën e Karavastasë. Njëri prej tyre, Pelikani kaçurrel ka qëndruar mes tyre. Taulanti, tregon historinë e kësaj specie të rrallë, dhe të problemeve emocionale të kësaj kolonie pelikani që u vendos në ishullin e vogël. Nëpërmjet Taulantit dalin në pah shumë probleme dhe zgjidhje.

**A DALMATIAN IN KARAVASTA (2013)**

**ALBANIA - Directed by Eol Çashku - Running time: 20 min**

A passionate biodiversity expert, and current Deputy Minister for Environment, is observing birds from a far distance. A lot of different species of birds populate the Karavasta Laguna. One of them, the Dalmatian Pelican has settled between them. Mr.Bino, exposes the story of this rare specie, and the problems this very emotional pelicans colony that settled in a small island on the backwaters. Through Mr.Bino many problems and solutions are brought to light.



**LIQENI (2013)  
SHQIPËRI - Në drejtimin e  
Sabir Kanaqi -**

**Kohëzgjatja: 20 min**

Sulejman Sulçe, specialist i lartë i mjedisit dhe bujqësisë udhëton drejt Shkodrës për të inspektuar problemet e ndotjes në Liqenin e Shkodrës dhe për të marrë pjesë në një seminar rajonal me kolegët e


tyre malazezë që punojnë për ruajtjen e liqenit. Jelena Janjuseviç një aktiviste e mjedisit nga shoqata Greenhome shkon për të inspektuar anën malazeze të liqenit dhe probleme të ndryshme që ata hasin. Nëpërmjet udhëtimit të tyre paralel nga të dy anët e liqenit ne zbulojmë një realitet të ashpër. Gjërat kanë filluar të ndryshojnë dhe ata të dy ndihen të sigurt edhe pse problemet janë të vazhdueshme.

**THE LAKE (2013)**

**ALBANIA - Directed by Sabir Kanaqi - Running time: 20 min**

Sulejman Sulçe a senior environment and agriculture specialist drives to Shkodra to inspect the Shkodra Lake pollution problems and attend a regional workshop with Montenegrin colleagues working on the preservation of the lake. Jelena Janjuseviç a environment activist from Green-Home association goes to inspect the Montenegrin side of the lake exposing different problems they face. Through their parallel journey from both sides of the lake we discover a tough reality. Things are starting to change and they both feel trusty even if the problems are persistent.





## LE PEUPLE MIGRATEUR / SHPENDËT MIGRATORË (2001)

**FRANCË** – Në drejtimin e Jacques Perrin. Skenari nga Stéphane Durand dhe Jacques Perrin -

**Kohëzgjatja: 89 min.**

Në zonat më klimë të butë në rruzull, zogjtë drejtohen në veri gjatë verës, duke udhëtuar qindra e madje mijëra kilometra. Gjatë rrugëtimit ato duhet të merren me rreziqe që i shfaq jo vetëm klima dhe kafshët e tjera, por edhe njerëzit dhe pasojat mjedisore të zhvillimit industrial. Dhe përballen sërish me këtë edhe në dimër.

Kolona muzikore e Bruno Coulais është regjistruar në gjuhën bullgare nga disa grupe vokale bullgare, si dhe në anglisht nga Nick Cave dhe Robert Wyatt. Efektet vokale përfshijnë sekuenca në të cilat gulcimi është mbivendosur me rrahjet e krahëve për të dhënë efektin se shikuesi është një zog.

Filmi ishte nominuar për filmin dokumentar më të mirë në Academy Award. Ajo fitoi

"Montazhi më i mirë" në Awards Cesar 27, ku ajo ishte nominuar edhe për "Muzika më e mirë" dhe "debutimi më i mirë".

<http://www.sonyclassics.com/wingedmigration/home.html>

## LE PEUPLE MIGRATEUR (2001)

**FRANCE** - Directed by Jacques Perrin.


**Screenplay by Stéphane Durand and Jacques Perrin - Running time: 89 min.**

Across the globe's more temperate areas, the birds head north in the summer, travelling hundreds or even thousands of miles. En route they must deal with the dangers posed not only by the climate and other animals, but also humans and the environmental consequences of industrial development. And then they do it all over again in the winter.

The film's soundtrack by Bruno Coulais was recorded by several Bulgarian vocal groups in Bulgarian, as well as Nick Cave in English and Robert Wyatt. The vocal effects include sequences in which panting is superimposed on wing beats to give the effect that the viewer is a bird.

The film was nominated for an Academy Award for Best Documentary Feature. It won "Best Editing" at the 27th César Awards, where it was also nominated for "Best Music" and "Best Debut".

<http://www.sonyclassics.com/wingedmigration/home.html>



## WILD BALKANS / BALLKANI I EGËR (2010)

SHBA - National Geographic -

Kohëzgjatja: 60 min

Gadishulli i Ballkanit njihet si një nga fushëbetejat më të mëdha në histori. Prapëseprapë, ka një tjetër anë që pak e njohin, ku pyje të lashta e ligatina të gjera kanë natyrë të paprekur; shkëmbinj të thepisur e pllaja të vetmuara ruajnë një të kaluar në dukje të pandryshuar. Duke parë këto peisazhe të ashpra e mbresëlënëse, mund të mendosh se gjendesh në Tokën e Mesme të J.R.R. Tolkien, tek libri Kryezoti i Unazave.

Në fakt, Gadishulli i Ballkanit është shtëpi e një shumëllojshmërie rajonesh që kufizohen me mitiken. Në Ligatinat Kopacki Rit në Kroaci, minat tokësore i mbajnë njerëzit tutje, çka u le-

jon gjallesave të egra të mbijetojnë. Më në jug, Lumi Tara në Mal të Zi përshkon kanionin më të gjatë e më të thellë në Evropë, ndërsa pyjet fqinje strehojnë kafshë të rralla si Rrëqebulli i Ballkanit. Më në lindje, miliona shpendë bëhen tufa në Grykëderdhjen e Danubit ku ushqehen me mizëri mushkonjash. Dhe, në perëndim të Ballkanit është Liqeni i Shkodrës, një reliev i jashtëzakonshëm me kreshta e ujë. Ky është udhëtim në një botë në dukje të harruar nga koha. Është Ballkani i egër.

## WILD BALKANS (2010)

USA - National Geographic - Running time: 60 min

The Balkan Peninsula is notorious for being one of the great battlegrounds of history. And yet, it possesses another side unknown to many, where ancient forests and vast wetlands harbor pristine wilderness, and sheer cliff walls and desolate plateaus preserve a seemingly unchanged past. Surveying these striking and stark landscapes, one might think they've ventured into the Middle-earth of J.R.R. Tolkien's Lord of the Rings.

Indeed the Balkan Peninsula is home to a variety of regions that border on mythical. In Croatia's Kopacki Rit Wetlands, land mines keep people away, but enable native wildlife to thrive. Further south, Montenegro's Tara River carves through Europe's longest and deepest canyon, and neighboring forests provide refuge to rare animals such as the Balkan Lynx. To the east, millions of birds flock to the Danube Delta to feast on swarms of mosquitoes. And at the west of the Balkans is Skodra Lake, a remarkable landscape of peaks and water.

This is a journey to a world seemingly forgotten by time. This is the wild Balkans.

## BURIMET E MBETJEVE WASTE RESOURCES

*Cdo ditë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prodhohet mjaftueshëm mbetje, po aq sa peshon gradaçela Empire State.*

*Everyday in the United States, it is produced enough trash to equal the weight of the Empire State Building*

Një Pemë



Një Jetë!



## AJËR (2011)

**SHQIPËRI - Realizuar nga studentët e vitit të tretë 2010-2011 të Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi -**

**Kohëzgjatja: 17 min**

Filmi Ajër na sjell në botën magjepëse të ndotjes së ajrit. Në një analizë të gjalla dhe teknike të çështjeve të ndotjes

së ajrit në Tiranë, mund të shohim sfidën përpara ndërkohë që propozohen disa zgjidhje për të lehtësuar barrën e ndotjes në shëndetin e njerëzve.

## AIR (2011)

**ALBANIA - Realized by third year students 2010-2011 of the Academy of Film and Multimedia Marubi - Running time: 17 min.**

Air brings us to the fascinating world of Air Pollution. In a vivid and technical analysis of the air pollution issues in Tirana, one can see the challenge ahead meanwhile some solutions are proposed to alleviate the burden of pollution on people's health.



## DRITARJA PREJ BETONI (2013)

**SHQIPËRI - Në drejtimin e Eldi Qesku -**

**Kohëzgjatja: 20 min**


Eldi një student në akademinë e filmit jeton në Tiranë, në një zonë të brendshme urbane në afërsi të malit të Dajtit. Pak vite më parë zona ka qenë një kodër e gjelbër përreth

kryeqytetit. Sot, për shkak të mungesës së një masterplani për zhvillim, ndërtesat e betonta të qytetit zëvendësuan pyllin e gjelbër të së kaluarës. Për më tepër kjo ndodh pranë Institutit Kombëtar Bërthamor. Eldi, përmes personazheve të tij, na sjell realitetin ku ai jeton. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Tiranë po përgatit masterplanin e qytetit.

## CONCRETE WINDOW (2013)

**ALBANIA - Directed by Eldi Qesku - Running time: 20 min**

Eldi a young film maker lives in Tirana, inner-urban area close to Dajti Mountain. Few years ago that area used to be a green hill surrounding the capital. Today, due to the lack of a master plan for the development of the city concrete buildings replaced the green forest of the past. Furthermore this happens right next to the National Nuclear Institute. Eldi, through his characters, brings us to the reality he lives in. The Faculty of Civil Engineering of Tirana is preparing the master plan of the city.



## SUBMISSION / NËNSHTRIM (2011)

**SUEDI - Në drejtimin e Stefan Jarl -  
Kohëzgjatja: 87 min**

Dikur, njerëzit përdornin 1 milion tonë kimikate në vit; shifra sot arrin në 500 milion tonë. Industria kimike rritet më shpejt nga të tjerat në botë dhe filmi tregon për 100.000 kimikatat që ne përdorim çdo ditë, përse përdoren dhe ç'na bëjnë ato neve dhe shëndetit tonë. Jo thjesht lëndë të shtuara ushqimore, por edhe kimikate para të cilave ekspozohemi çdo ditë e kudo: lëndë zbutëse, lëndë vonuese të ndezjes, lëmuesa e kështu me radhë.

Duke u këshilluar me një seri shkencëtarësh nga Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Kanadaja, Gjermania, Zvicra, Spanja, Finlanda, Danimarka dhe Suedia, producenti i filmit Stefan Jarl kërkon përgjigje për pyetjet: Çfarë problemesh mund të shkaktojnë këto kimikate? Çfarë po u lëmë trashëgim fëmijëve tanë ende të palindur? Dhe pse dorëzohemi?

## SUBMISSION (2011)

**SWEDEN - Directed by Stefan Jarl - Running time: 87 min**

Back then, humans used 1 million tonnes of chemicals per year; the figure today is 500 million tonnes. The chemical industry is the fastest-growing industry in the world and this film is about the 100,000 chemicals we use every day, what they're used for and what they do to us and our health. Not only food additives – but the chemicals we are exposed to in our daily environments: softeners, flame retardants, surfactants and so on.

Consulting a wide range of scientists from the United States, the UK, Canada, Germany, Switzerland, Spain, Finland, Denmark and Sweden, documentary film maker Stefan Jarl seeks answers: What problems can these chemicals cause? What are we passing on to our unborn children? And why do we submit?

## NDRYSHIMI KLIMATERIK CLIMATE CHANGE

*Kur ju bleni produktet lokale ju shmangni kilometra transporti, litra nafte, kilogramë të dioksidit të karbonit dhe ju fitoni shije dhe freski!*

*When you buy local products, you avoid kilometers of transport, liters of fuel, kilograms of CO2...and you win taste and freshness!*





## PET 127 - PLASTIC EMERGENCY ALBANIA

*SHQIPËRIA - Prodhuar nga CoPlan - Kohëzgjatja: 5 min*

Nga koha e rrjetës së najlonit, trastave dhe shisheve të qelqit, profili i konsumatorit shqiptar është tjetërsuar përtej njohjes. Në 21 vjet, ne kemi zëvendësuar çdo sjellje konsumatorizmi për të vetmen arsye sepse kemi mundësinë të zgjedhim. Tendenca jonë për konsum të shfrenuar njëpërdorimësh është rritur kaq shumë, sa ka filluar të bjerë ndesh dukshëm me mjedisin ku jetojmë. Me pak vullnet dhe fantazi, ne mund të shndërrojmë problemin e ndotjes në zgjidhje. Historia e suksesit vazhdon, tek sa ka filluar puna për një stacion të dytë!

## PET 127 - PLASTIC EMERGENCY ALBANIA

**(2012)**

*ALBANIA - Produced by CoPlan*

*Running time: 5 min*

From the time of the nylon bags, and glass-water-bottles, the Albanian consumer profile, has changed beyond recognition. Our tendency for consuming goods packaged in disposable wrapping, has increased so much that has been apparent clash with the environment in which we live. With a little willpower and fantasy, we can transform the problem of pollution into a beautiful sustainable solution. The success story continues as a second bus shelter is under way!

## UJI WATER

*Bërja e një dushi kërkon 40 deri 60 litra ujë, ndërsa larja në vaskë kërkon 120 deri 200 litra. Nëse të gjithë banorët e Shqipërisë nuk do të bënin dush por do të lahashin në vaskë për një ditë, diferenca e ujit të harxhuar do të ishte me 480 000 000 litra në ditë...*

*To take a shower you need between 40 and 60 liters of water, whereas if you take a bath, it is 120 to 200l. If all the inhabitant of Albania were taking one bath and not one shower per day, the difference will be 480 000 000 liters per day....*

# SHKODËR

## E MËRKURË, 22 MAJ

### *Rruga pedonale*

**09.00 – 20.00**

Ekspozitë me foto: "Biodiversiteti ynë – krenaria jonë"

**09.00 – 12.00**

Aktivite edukuese në shkolla "Testi i cilësisë së ujit"

### *Shfaqje përjashta,*

**20:00 – 20:30**

Ceremonia e hapjes dhe muzikë

**20:30 – 23:00**

Pelikani Kaçurrel

Ballkani i egër

Liçeni - premiera në Shqipëri

## E ENJTE, 23 MAJ

### *Rruga pedonale (pranë Bashkisë)*

**09.00 – 20.00**

Ekspozitë me foto: "Biodiversiteti ynë – krenaria jonë"

**09.00 - 12.00**

Aktivite edukuese në shkolla "Biodiversiteti i pasur: specie dhe habitate"

**17.30 – 19.00**

Teatri lëvizës: "Zëri i detit"

### *Shfaqje përjashta,*

**20:30 – 23:00**

Nata e dokumentarëve Shqiptarë

1 - Eksperiencia nga komuna e Shkrelit

2 - Dritarja prej betoni - premiera në Shqipëri

3 - Kujdes bicikletat

4 - Rastësisht e mërkurë - premiera në Shqipëri

5 - Ajër

6 - Libër

7 - Dita me mot të kthjellët - premiera në Shqipëri

8 - Lana - premiera në Shqipëri

9 - Kujtesë plastike - premiera në Shqipëri

10 - Peshkimi

## WEDNESDAY 22 MAY

### *Pedestrian Street*

**09.00 – 20.00**

Open Area Photo Exhibition: "Our Biodiversity – Our Pride"

**09.00 – 12.00**

School Education Activity "Water quality testing"

### *Outside Screen,*

**20:00 – 20:30**

Opening Ceremony and music

**20:30 – 23:00**

A Dalmatian in Karavasta

Wild Balkans

The Lake - premiere in Albania

## THURSDAY 23 MAY

### *Pedestrian Street*

*(near Municipality building)*

**09.00 – 20.00**

Open Area Photo Exhibition: "Our Biodiversity – Our Pride"

**09.00 - 12.00**

School Education Activity "Rich Biodiversity: species and habitats"

**17.30 – 19.00**

Moving Theatre: "Voice of the Sea"

### *Pedestrian Zone Outside Screen,*

**20:30 – 23:00**

Albanian Doc Night

1 - Experience from Shkrelli commune

2 - Concrete Window - premiere in Albania

3 - Mind the Bikes - premiere in Albania

4 - Ordinary Thursday - premiere in Albania

5 - Air

6 - Book

7 - The day of Clear Weather - premiere in Albania

8 - Lana - premiere in Albania (15 min)

9 - Plastic memory - premiere in Albania (15 min)

10 - Fishing

## BIODIVERSITETI BIODIVERSITY

*Rrëqebulli euroaziatik ecën deri 20 km në natë dhe territori i tij është deri në 450 km<sup>2</sup> (pothuaj sa gjysma e madhësisë së qarkut të Durrësit)*

*The Eurasian lynx can travel up to 20 km during one night, and one territory can be up to 450 km<sup>2</sup> (around half of the size of Qarku of Dures)*

## E PREMTE, 24 MAJ

*Pruga pedonale*

09.00 – 20.00

Ekspozitë me foto: “biodiversiteti ynë – krenaria jonë”

*Shfaqje përjashta,*

20:30 – 23:00

Liçeni

Hedhurinë - premiera në Shqipëri

## E SHTUNË, 25 MAJ

*Shfaqje përjashta, 20:00 – 23:00*

Aty ku fillon Joni

Skalitur në kohë

Shkrirja e Arktikut

Planet Ri:Mendo

## FRIDAY 24 MAY

*Pedestrian Street*

09.00 – 20.00

Open Area Photo Exhibition: “Our Biodiversity – Our Pride”

*Outside Screen, 20:30 – 23:00*

The Lake

Trashed - premiere in Albania

## SATURDAY 25 MAY

*Outside Screen, 20:00 – 23:00*

Where Jonian begins

Crafted by time

Melting Arctic

Planete Re:Think

## BURIMET E MBETJEVE WASTE RESOURCES

*Nëse Pjetër Bogdani do të përdorte shishe plastike, nuk do të ishin dekompozuar ende! Një shishe plastike i duhen 450 vite për tu dekompozuar, dhe një qese më shumë se 20 vjet. Po ashtu, ky proces dekompozimi i produkteve plastike çliron në mjedis komponentë toksik për njerëzit.*

*If Pjeter Bogdani was using plastic bottles, it will not be yet decomposed! It is needed 450 years to totally decompose a bottles of plastic, and more than 20 for a plastic bag. Also, the decomposition of these plastic products put in the environment toxic components for the humans.*



# KORÇA

## E MËRKURË, 22 MAJ

**Teatri, 19:30 – 23:00**

Pelikani Kaçurrel

Shpendët migratorë - premiera në Shqipëri

Liçeni - premiera në Shqipëri

## E ENJTE, 23 MAJ

**Teatri,**

**10:00 -13:30**

Program special për fëmijët:

Mia dhe Migou

**16:00**

Fjalë përshëndetëse e Ambasadorit të Suedisë

**16:30**

Dorëzimi - shfaqje speciale

**18:00**

Diskutim mbi filmin

**20:00 – 22:30**

Kujtesë plastike - premiera në Shqipëri

Kujdes biçikletat - premiera në Shqipëri

Rastësisht e mërkurë - premiera në Shqipëri

Planet Ri:mendo - premiera në Shqipëri

## WEDNESDAY 22 MAY

**Theater of Korca, 19:30 – 23:00**

A Dalmatian in Karavasta - premiere in Albania

Le Peuple migrateur - premiere in Albania

The Lake - premiere in Albania

## THURSDAY 23 MAY

**Theater of Korca,**

**10:00 -13:30**

Special for Kids:

Mia and Migou

**16:00**

Welcome of the Swedish Ambassador

**16:30**

Submission - Special screening

**18:00**

Discussion on the film

**20:00 – 22:30**

Plastic memory - premiere in Albania

Mind the Bikes - premiere in Albania

Ordinary Thursday - premiere in Albania

Planet Re:think - premiere in Albania

## BURIMET E MBETJEVE

### WASTE RESOURCES

*Nëse gjithë banorët e botës jetojnë si një amerikan i zakonshëm, do të na duheshin 5 planetë për të siguruar burimet e mjaftueshme*

*If the entire world lived like the American average, we should need 5 planets to provide enough resources.*

## UJI

### WATER

*Mesatarisht, 40 litra ujë harxhohen në ditë për person. Një fermer në Madagaskar konsumon 10 litra, një francez 240 litra, dhe një amerikan 600 litra. (CNRS 2004)*

*On average, 40 liters of water are consumed per person/day. A Madagascan farmer consumes 10 liters, a Parisian 240 liters, and an American 600 liters. (CNRS 2004)*

## E PREMTE, 24 MAJ

**Teatri, 10:00 -13:30**

Program special për fëmijët:  
Mia dhe Migou  
Planeti Plastik

**19:00 – 23:00**

Liqeni  
Zgjidhje vendore për probleme globale  
Ballkani i egër

## E SHTUNË, 25 MAJ

**Teatri, 18:30 – 20:00**

Hedhurinë

## FRIDAY 24 MAY

**Theater of Korca, 10:00 -13:30**

Special for Kids:  
Mia and Migou  
Plastic Planet

**19:00 – 23:00**

The Lake  
Solutions Locales pour Désordre Global / Think  
Global, Act Rural  
Wild Balkans

## SATURDAY 25 MAY

**Theater of Korca, 18:30 – 20:00**

Trashed

### URBANIZIMI URBANIZATION

*Në Evropë 31 metra katror tokë natyrale transformohen në çdo sekondë në zona urbane. Për një vit transformohen 40, 73 kilometra katrorë, po aq sa madhësia e bashkisë së Tiranës.*

*In EU, 31 m square of natural lands are each second transformed into a urban area. After one year, it is 40,73 kilometers square that are transformed, which represent the size of municipality of Tirana.*

### BIODIVERSITETI BIODIVERSITY

*Së paku 2 billion m2 pyje tropikal humbasin çdo vit, pothuaj një zone e madhësisë së Anglisë, Uellsit dhe Skocisë së bashku.*

*At least 50 million acres of rainforest are lost every year, totaling an area the size of England, Wales and Scotland combined.*

# TIRANE

## E MËRKURË, 22 MAJ

**Kinema Millennium, 10:00- 12:00**

Ceremonia e hapjes

Përmbledhje e dokumentarëve më të mirë ndërkom-bëtar dhe shqiptar të Festivalit të Filmit Mjedisor Arktiku në shkriçe - premiera në Shqipëri  
Pelikani Kaçurrel - premiera në Shqipëri  
Ballkani i egër - premiera në Shqipëri

**Tirana International Hotel, 14:00 - 16:30**

Workshop shkencor mbi biodiversitetin

**Kinema Millennium, 18:00 - 20:00**

Liçeni premiera në Shqipëri  
Planeti Ri:mendo premiera në Shqipëri

**Zona Pedonale, projektim jashtë**

**20:30 - 23:00**

Pelikani Kaçurrel  
Shpendët Migratorë - premiera në Shqipëri  
Lana - premiera në Shqipëri

## E ENJTE, 23 MAJ

**Kinema Millennium, 18:00 - 20:00**

Libër

Zgjidhje vendore për probleme globale - premiera në Shqipëri

**Zona Pedonale, projektim jashtë**

**20:30 - 23:00**

Nata e dokumentarëve Shqiptarë  
1 - Dritarja prej betoni - premiera në Shqipëri  
2 - Kujdes Biçikletat - premiera në Shqipëri  
3 - Rastësisht e mërkurë - premiera në Shqipëri  
4 - Ajër  
5 - Dita me mot të kthjellët premiera në Shqipëri  
6 - Magnet - premiera në Shqipëri  
7 - Kabëll - premiera në Shqipëri  
8 - Kujtesë plastike - premiera në Shqipëri  
9 - PET 127 - Plastic Emergency Albania  
10 - Gjendja e trafikut është pasqyrë e shoqërisë

## WEDNESDAY 22 MAY

**Millennium Cinema, 10:00 - 12:00**

Opening Ceremony

All the trailers of the best international and Albanian docs at the Environment Film Festival  
Melting Arctic - premiere in Albania  
A Dalmatian in Karavasta - premiere in Albania  
Wild Balkans - premiere in Albania

**Tirana International Hotel, 14:00 - 16:30**

Scientific Workshop on Biodiversity

**Millennium Cinema, 18:00 - 20:00**

The Lake - premiere in Albania  
Planete Re:think - premiere in Albania

**Pedestrian Zone Outside Screen**

**20:30 - 23:00**

A Dalmatian in Karavasta  
Le Peuple Migrateur - premiere in Albania  
Lana - premiere in Albania

## THURSDAY 23 MAY

**Millennium Cinema, 18:00 - 20:00**

Book

Solutions Locales pour Désordre Global / Think Global, Act Rural - premiere in Albania

**Pedestrian Zone Outside Screen**

**20:30 - 23:00**

Albanian Doc Night  
1 - Concrete Window - premiere in Albania  
2 - Mind the Bikes - premiere in Albania  
3 - Ordinary Thursday - premiere in Albania  
4 - Air  
5 - The day of Clear Weather - premiere in Albania  
6 - Magnet - premiere in Albania  
7 - Cable - premiere in Albania  
8 - Plastic memory premiere in Albania  
9 - PET 127 - Plastic Emergency Albania  
10 - The state of traffic mirrors the state of the society

## E PREMTE, 24 MAJ

### **Teatri i Komedisë, 10:00 - 13:30**

Program special për fëmijët:  
Mia dhe Migou  
Planeti Plastik

### **Kinema Millennium, 18:00 - 20:00**

Italia e pambaruar - premiera në Shqipëri  
Intervistë e shkurtër dhe debat me regjisorin e dokumentarit.

### **Zona Pedonale, projektim jashtë**

**20:30 - 23:00**

Aty ku fillon Joni  
Skalitur nga koha - premiera në Shqipëri  
Ballkani i egër  
Arktiku që shkrin

## **E SHTUNË, 25 MAJ**

### **Teatri i Komedisë, 10:00 - 13:30**

Mëngjes - Përkujdes:  
Shlyerja e borxhit - premiera në Shqipëri  
Dorëzimi  
Panair i OJFve Mjedisore

### **Kinema Millennium,**

**17:30 - 18:30**

Sfilatë mode

**18:30 - 19:45**

Hedhurinë

**19:45**

Mbyllja e Festivalit të Filmit Mjedisor

## **FRIDAY 24 MAY**

### **Theater of Comedy, 10:00 - 13:30**

Special for Kids:  
Mia and Migou  
Plastic Planet

